



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), si dhe nenin 4, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 38 / 24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2023, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E KOMISIONEVE DHE SHPENZIMEVE OPERATIVE TË SIGURUESVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe kufizimet për menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve për siguruesit jo-jetë.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë Siguruesit jo-jetë të licencuar nga BQK-ja që operojnë në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizime**

Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet dhe nenin 2 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

### **Neni 3**

#### **Kufizimet e përgjithshme**

1. Siguruesit e licencuar për të vepruar në sektorin e sigurimeve jo-jetë në Republikën e Kosovës nuk mund të krijojnë shpenzime të cilat tejkalojnë kufizimet brenda periudhës raportuese të përcaktuar me nenin 7 të kësaj rregulloreje.
2. Pavarësisht kufizimeve të përcaktuara me këtë rregullore, siguruesit duhet të sigurohen që në çdo kohë të mbajnë mjete të mjaftueshme për pagesën e dëmeve dhe ti trajtojnë ato me prioritetin më të lartë.

#### **Neni 4**

##### **Kufizimi i shpenzimeve lidhur me komisionet e paguara për ndërmjetësuesit e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia**

1. Siguruesit, mund të aplikojnë komision (përfshirë të gjitha shpenzimet tjera) për ndërmjetësuesit në sigurime sa i përket produktit të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, deri në maksimum 8%
2. të primit të shkruar bruto pa TVSH pas kthimeve dhe anulimeve nga sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësise.
3. Në rastet e kthimit dhe anulimit të policave duhet të kthehet edhe komisioni i paguar për pjesën e mbetur të policës. Ndërprerja, anulimi dhe zëvendësimi i policës së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia duhet të bëhet në harmoni me Udhëzimin përkatës të BQK-së.
4. Kërkesa për kthim të primit të sigurimit duhet të bëhet vetëm për dhe në llogari të të siguarit nga siguruesi përkatës.
5. Siguruesit në asnjë rast nuk mund të aplikojnë komisione për punonjësit e siguruesit të cilët janë përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimit.
6. Transferimi i pagesës së komisioneve dhe shpenzimeve të ndërmjetësuesve për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të parapara me nenin 3 të kësaj rregulloreje duhet të bëhet vetëm me transfer bankar, nga llogaria bankare e dedikuar për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 5**

##### **Mbajtja e mjeteve në llogari bankare**

1. Siguruesit janë të obliguar të mbajnë vetëm një llogari bankare, në të cilën grumbullojnë mjetet e arkëtuara nga shitja e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
2. Siguruesit duhet të sigurojnë gjatë gjithë kohës fonde të mjaftueshme për pagesën e dëmeve, financimin e Fondit të kompensimit dhe shpenzimeve tjera.
3. Përpos pagesës së dëmeve, Fondit të Kompensimit, pagesës së komisioneve të ndërmjetësuesve dhe pjesës për shpenzime operative, llogaria e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të asnjë mënyrë të debitohet për qëllime tjera pa aprovimin paraprak të BQK-së (për qëllime tjera nënkupton të gjitha investimet, të përcaktuara me Rregulloren e aseteve për mbulimin e provizioneve teknike).

#### **Neni 6**

##### **Kufizimi i përgjithshëm i shpenzimeve administrative**

1. Siguruesit e licencuar jo-jetë në asnjë rast nuk mund të krijojnë shpenzime më shumë se 30 % të primit të shkruar bruto nga të gjitha klasët e sigurimit jo-jetë.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje shpenzimet e përgjithshme administrative konsiderohen të gjitha grupet e shpenzimeve të përcaktuara si në vijim:
  - 2.1. Shpenzimet për komisionet e ndërmjetësimit dhe shpenzimet tjera të shitjes;

- 2.2. Shpenzimet e stafit punonjës;
- 2.3. Shpenzimet e shërbimit dhe furnizimit nga furnitorët dhe palët e treta;
- 2.4. Shpenzimet e zhvlerësimit dhe provizionimit të llogarive të arkëtueshme nga sigurimet,
- 2.5. Shpenzimet për BKS si dhe shpenzime tjera të lidhura me primin e shkruar bruto;
- 2.6. Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promocionit të cilat nuk duhet të tejkalojnë 3% të primin të shkruar bruto pa TVSH;
- 2.7. Në rastet kur siguruesit nuk i është ndaluar me ndonjë masë tjetër, shpenzimet e sponsorizimeve të cilat nuk duhet të tejkalojnë 1% të primin të shkruar bruto pa TVSH.
3. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen në momentin e ndodhjes në raport me primin e shkruar bruto dhe të njëjtat nuk mund të kapitalizohen si shpenzime të shtyra.
4. Në llogaritjen e kufizimit të shpenzimeve të përgjithshme të siguruesit në raport me primin e shkruar bruto, përjashtohen shpenzimet si në vijim:
  - 4.1. Shpenzimet financiare të cilat lidhen me kostot investuese, shpenzimet për interesa nga kreditë bankare, shpenzimet që ndërlidhen me shërbimet bankare dhe shpenzimet tjera financiare.
  - 4.2. Shpenzimet të cilat rezultojnë nga humbja në vlerë, amortizimi dhe zhvlerësimi i asetëve financiare, jo-financiare, asetëve të prekshme dhe të paprekshme me përjashtim të provizionimit të llogarive të arkëtueshme të cilat rezultojnë nga aktiviteti i sigurimeve.
5. Shpenzime të reklamës dhe promocionit konsiderohen shpenzimet të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billboardat, reklamat tranzite e të tjera të ngjashme.
6. Kur aktiviteti i reklamës rezulton në të hyra të pritshme në të ardhmen të cilat tejkalojnë kostot e pritshme në të ardhmen për të realizuar të hyra nga shitja, Siguruesi duhet të jetë në gjendje të demonstrojë korrelacionin ndërmjet produktit apo shërbimit dhe shpenzimeve të marketingut duke u bazuar në të dhëna dhe modele historike të verifikueshme.
7. Siguruesit në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojnë paradhënie ndaj ndërmjetësuesve të sigurimeve, apo dikujt tjetër.

## **Neni 7**

### **Raportimi i Siguruesve në BQK**

1. Siguruesit, në baza tremujore, janë të obliguar që deri në ditën e fundit të muajit vijues, të raportojnë në mënyrë elektronike në BQK informatat si më poshtë:
  - 1.1. Formën e plotësuar me të dhënat e kërkuara sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.
  - 1.2. Raportin e primeve të shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për tremujorin paraparak së bashku me llogaritjen e komisionit dhe shpenzimeve tjera nga neni 3 i kësaj rregulloreje.
  - 1.3. Raportin e detajuar të pagesës së dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësishë përfshirë dhe pagesën për fondin e kompensimit.
  - 1.4. Raportin e detajuar të shitjes së sigurimeve vullnetare së bashku me llogaritjen e komisionit dhe shpenzimeve tjera relative

2. Periudha raportuese në baza tremujore përfshin llogaritjen e të dhënave së bashku me kufizimet e përcaktuara me këtë rregullore si në vijim:
  - 2.1. tremujori i parë, të dhënat nga data 01 janar deri me 31 mars të vitit raportues
  - 2.2. tremujori i dytë, të dhënat nga data 01 janar deri me 30 qershor të vitit raportues
  - 2.3. tremujori i tretë, të dhënat nga data 01 janar deri me 30 shtator të vitit raportues
  - 2.4. tremujori i katërt, të dhënat nga data 01 janar deri me 31 dhjetor të vitit raportues.
3. Në baza mujore, deri në ditën e fundit të muajit, siguruesit janë të obliguar që të raportojnë në BQK të gjitha transaksionet bankare lidhur me primet e shkruara, dëmet e paguara, shpenzimet dhe transaksionet tjera të periudhës.

## **Neni 8**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave administrative dhe dënimeve me gjobë siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr.05/L-045 për Sigurimet.

## **Neni 9**

### **Përshtatja e politikave**

Të gjithë siguruesit jo-jete janë të obliguar që brenda afatit tre mujor të përshtatin të gjitha politikat dhe procedurat e tyre të brendshme të shpenzimeve me kërkesat dhe kufizimet e kësaj rregulloreje.

## **Neni 10**

### **Shtojca**

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Shtojca 1 Forma e raportimeve.

## **Neni 11**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Menaxhimin e Komisioneve dhe Shpenzimeve Operative të Siguruesve e datës 30 janar 2020.

## **Neni 12**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 1 tetor 2023.

Bashkim Nurboja

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

## Shtojca 1:

### Forma e raportimeve

<b>Institucioni</b>	Siguruesi	
<b>Emri i formës</b>	Shpenzime Operative sipas klasave të sigurimeve	
<b>Valuta</b>	Euro	(përveç nëse është përcaktuar ndryshe)

Shpenzime Operative sipas klasave të sigurimeve	MTPL	Jo-MTPL	Gjithsej
<b>Primi i shkruar Bruto ne Euro</b>	-	-	-
<b>% e Primit të Shkruar Bruto</b>	<b>0.0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>
Komisionet për ndërmjetësuesit e shitjes			
Shpenzimet per stafin e shitjes			
Shpenzimet e blerjes së policave			
Shpenzimet për IRRT-Altec			
Shpenzime e pikave të shitjes (qera, material zyre etj)			
<b>Kosto e blerjes</b>			
<b>Kosto e stafit (pagat dhe shpenzimet tjera të stafit)</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>

Energji elektrike, Ujë dhe Ngrohje  
Karburant  
Donacione dhe Sponsorizime  
Materiale zyre, shkrimi etj  
Shpenzime për dhurata  
Pajisjet e zyrës dhe mirëmbajtja e mobiljeve  
Mirëmbajtja e paisjeve harduerike dhe automjeteve  
Qiratë  
Qira operative e automjeteve dhe qiraja të tjera  
Shpenzime komunikimi dhe rrjetet telefonike  
Shpenzimet e Postës  
Përfaqësim, Reklamim (Marketing)  
Shpenzime pastrimi dhe higjene  
Roje dhe Siguri  
Shpenzime Konsulence dhe Auditim  
Shpenzime për zhvillim të softuerit dhe licenca  
Shpenzimet e trajnimit të ndërmjetësuesve  
Shpenzime tjera për furnizime dhe shërbime

**Gjithsej shpenzime për palët e treta dhe furnizime**

Tarifa për BQK

Tarifa, taksa dhe ngarkesa tjera

**Gjithsej taksat dhe tarifat**

Provizionimi i llogarive të arkëtueshme nga primet

**Gjithsej shpenzimet për provizionim**

Provizionimi për humbjet e paparashikueshme

Shpenzime tjera

<b>Gjithsej Shpenzimet Administrative</b>	- €	- €	- €
-------------------------------------------	-----	-----	-----

Shpenzime administrative për BKS

Shpenzimet për Fondin e Kompensimit

Shpenzimet për Sigurime Kufitare

Shpenzimet për Shoqatën e Sigurimeve të Kosovë

<b>Gjithsej Shpenzimet Operative</b>	- €	- €	- €
--------------------------------------	-----	-----	-----

Përshkrimi	MTPL	Sigurime Kufitare	Karton jeshil	TPL+	Gjithsej MTPL
					-
<b>% e Primit të Shkruar Bruto</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>
Komisionet për ndërmjetësuesit e shitjes					- €
Shpenzimet për stafin e shitjes	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet e blerjes së policave	- €			- €	- €
Shpenzimet për IRRT-Altec					- €
Shpenzime e pikave të shitjes (qera, material zyre etj)	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Kosto e blerjes</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
<b>Kosto e stafit (pagat dhe shpenzimet tjera të stafit)</b>					
Energji elektrike, Ujë dhe Ngrohje	- €	- €	- €	- €	- €
Karburant	- €	- €	- €	- €	- €
Donacione dhe Sponsorizime	- €	- €	- €	- €	- €
Materiale zyre, shkrimi etj	- €	- €	- €	- €	- €

Shpenzime për dhurata	- €	- €	- €	- €	- €
Pajisjet e zyrës dhe mirëmbajtja e mobiljeve	- €	- €	- €	- €	- €
Mirëmbajtja e paisjeve harduerike dhe automjeteve	- €	- €	- €	- €	- €
Qiratë	- €	- €	- €	- €	- €
Qira operative e automjeteve dhe qiraja të tjera	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime komunikimi dhe rrjetet telefonike	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet e Postës	- €	- €	- €	- €	- €
Përfaqësim, Reklamim (Marketing)	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime pastrimi dhe higjene	- €	- €	- €	- €	- €
Roje dhe Siguri	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime Konsulence dhe Auditim	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime për zhvillim të softuerit dhe licenca	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet e trajnimit të ndërmjetësuesve	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime tjera për furnizime dhe shërbime	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej shpenzime për palët e treta dhe furnizime</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
Tarifa për BQK	- €	- €	- €	- €	- €
Tarifa, taksa dhe ngarkesa tjera	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej taksat dhe tarifrat</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
Provizionimi i llogarive të arkëtueshme nga primet	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej shpenzimet për provizionim</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
Provizionimi për humbjet e paparashikueshme	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime tjera	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej Shpenzimet Administrative</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
Shpenzime administrative për BKS	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet për Fondin e Kompensimit	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet për Sigurime Kufitare	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet për Shoqatën e Sigurimeve të Kosovë	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej Shpenzimet Operative</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>

Përshkrimi	Aksident dhe Shëndet	Marinë dhe Transport	Kasko	Sigurime kundër zjarrit dhe	Sigurim i përgjegjësisë	Sigurim i kredive dhe Garancioneve	Sigurim i humbjeve financiare	Gjithsej Jo-MTPL
------------	----------------------	----------------------	-------	-----------------------------	-------------------------	------------------------------------	-------------------------------	------------------

dëmtimeve  
tjera në pronë

<b>% of Non-MTPL Gross Premium Written</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>
Komisionet për ndërmjetësuesit e shitjes								- €
Shpenzimet për stafin e shitjes	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet e blerjes së policave	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet për IRRT-Altec								
Shpenzime e pikave të shitjes (qera, material zyre etj)	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Kosto e blerjes</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
<b>Kosto e stafit (pagat dhe shpenzimet tjera të stafit)</b>								
Energji elektrike, Ujë dhe Ngrohje	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Karburant	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Donacione dhe Sponsorizime	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Materiale zyre, shkrimi etj	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime për dhurata	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Pajisjet e zyrës dhe mirëmbajtja e mobileve	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Mirëmbajtja e pajisjeve harduerike dhe automjeteve	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Qiratë	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Qira operative e automjeteve dhe qiraja të tjera	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime komunikimi dhe rrjetet telefonike	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet e Postës	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Përfaqësim, Reklamim (Marketing)	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime pastrimi dhe higjienë	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Roje dhe Siguri	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime Konsulence dhe Auditim	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime për zhvillim të softuerit dhe licenca	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzimet e trajnimit të ndërmjetësuesve	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime tjera për furnizime dhe shërbime	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej shpenzime për palët e treta dhe furnizime</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
Tarifa për BQK	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Tarifa, taksa dhe ngarkesa tjera	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej taksat dhe tarifatat</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
Provizionimi i llogarive të arkëtueshme nga primet	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej shpenzimet për provizionim</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>
Provizionimi për humbjet e paparashikueshme	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Shpenzime tjera	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej Shpenzimet Administrative</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>



Shpenzime administrative për BKS									
Shpenzimet për Fondin e Kompensimit									
Shpenzimet për Sigurime Kufitare									
Shpenzimet për Shoqatën e Sigurimeve të Kosovë	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €	- €
<b>Gjithsej Shpenzimet Operative</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>	<b>- €</b>

<b>Institucioni</b>	Siguruesi
<b>Emri i formës</b>	
<b>Valuta</b>	Euro (përveç nëse është përcaktuar ndryshe)

**Shpenzimet e stafit** **Gjithsej**

<b>Numri i punonjësve</b>	
Staf menaxherial (Drejtorë dhe CEO)	
Personeli punonjës në Qendër (përveq drejtorëve dhe CEO)	
Staf në pikat e shitjes që paguhen me pagë fikse	
<b>Agjentët e shitjes të cilë paguhen me komisione</b>	
Tjerë	
<b>Gjithsej</b>	-
<b>Shpenzimet për paga, kontribute dhe benefite tjera</b>	
Staf menaxherial (Drejtorë dhe CEO)	
Personeli punonjës në Qendër	
Stafi në pikat e shitjes që paguhen me pagë fikse	
Tjerë	
<b>Gjithsej kostot e stafit</b>	€ -

**Institucioni** Siguruesi

**Emri i formës****Valuta**

në (%)

(përveç nëse është përcaktuar ndryshe)

<b>Kufizimet sipas rregullores</b>	<b>Aktuale në %</b>	<b>Sipas rregullores, jo më shumë se:</b>
<b>Treguesit në përqindje</b>		
Shpenzimet për komisione nga MTPL	0%	8%
Përfaqësim, Reklama dhe Promocion	0%	3%
Sponsorizime	0%	1%
<b>Gjithsej Raporti i Shpenzimeve</b>	<b>0%</b>	<b>30%</b>